



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 07, datë 28.12.2020

**PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KAVAJË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 2, DATË 27.04.2018,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 2, datë 27.04.2018 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Kavajë Nr. 133, datë 23.12.2020 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkia Kavajë”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë të miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 27.04.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e Rregullores së Planit:

- *Pjesa I, Kreu V “Zbatueshmëria dhe rregullat e veçanta të zhvillimit”, Shtimi i nenit 31/1;*
- *Pjesa II, Kreu I “Rregullat e zonave të banimit”, Shtimi i nenit 36/1;*
- *Pjesa II, Kreu I, “Rregullat e zonave të banimit”, Neni 41 “Zonat A21- Zona të formuara me banesa kolektive”;*
- *Pjesa II, Kreu I “Rregullat e zonave të banimit”, Neni 42 “Zonat A22- Zona të reja”;*
- *Pjesa II, Kreu I “Rregullat e zonave të banimit”, Neni 43 “Zonat A22-Zona të reja”;*
- *Pjesa II, Kreu II, “Rregullat e zonave industriale dhe ekonomike”, Neni 63 “Zonat IE-Zonë industriale dhe ekonomike”;*
- *Pjesa II, Kreu III, “Rregullat e zonave të shërbimit”, Neni 65 “Zonat S1-Zonë shërbimi”;*
- *Pjesa II, Kreu VIII, “Rregullat e zonave për aktivitete sociale dhe rekreative”, Neni 78 “AR4-Zona Rekreative”;*
- *Pasaportat e njësive strukturore.*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë,

shkëlidhur këtij Vendimi.

Ngarkohen Bashkia Kavajë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

3. Ngarkohen Bashkia Kavajë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LËDIA TOTA

